

PROCESVERBAL

Nga Kuvendi Themelues i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës, i mbajtur me 14.04.2013. në Gjenevë

Me ftesë të Këshillit Organizativ për themelimin e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës në përbërje:

1. Ajet Hyseni
2. Ali Mehmeti
3. Ardian Reka
4. Arif Ejupi
5. Avdyl Gërvalla
6. Endri Veshi
7. Erenik Yzeiraj
8. Fadil Avdija
9. Ismet Kurteshi
10. Nebi Hyseni
11. Nexhat Xhymshiti
12. Nexhmedin Ilazi
13. Skender Svarqa

dhe në praninë e 96 personave tjerë, anëtari më i moshuar i Këshillit Organizativ (në tekstin e mëtejme KO), z. Avdyl Gërvalla, në orën 16h00, hapi punimet duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke propozuar këtë

REND DITE

1. Prezantimi dhe aprovimi i Statutit të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës,
2. Zgjedhja e kryesisë dhe e kryetarit,
3. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë,
4. Zgjedhja e anëtarëve për organin e kontrollit të kontos dhe
5. Të ndryshme

Ky rend dite u aprovua njëzëri dhe u kalua në pikën e parë.

1. Prezantimi dhe aprovimi i Statutit të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës;

Kryesuesi z. Avdy Gërvalla ia dha fjalën z. Ali Mehmeti që ta prezantoj Projekt-Statutin e propozuar.

Z. Ali Mehmeti informoi të pranishmit se ky projektstatut është prezantuar qysh në fund të vitit të kaluar në versionin e tij të parë. Versioni i dytë në fund të janarit të këtij viti, kurse versioni që sot keni para vetës në mes të muajit mars. Çdo version i këtij projektstatuti është shpërndarë në mbi 100 adresa të ndryshme elektronike këtu në Gjenevë. Po ashtu është prezantuar edhe në sajtin e Internetit, të krijuar në emër të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës (në tekstin e mëtejme KShGj-së). Nga aty ka mundur ta shkarkoj kush ka dashtë. Po ashtu në hyrje të sallës, kanë mundur ta marrin edhe versionin në letër. Prezantimi është bërë me Power Point, në formë të diapozitivit. Disa nene vetëm janë lexuar, kurse disa edhe janë komentuar. Janë komentuar sidomos ato, rreth të cilave edhe në diskutime paraprake ka pasur mendime të ndryshme.

Edhe pse me rendin e ditës nuk ishte paraparë të hapet diskutimi rreth ndryshimeve eventuale, pasi që për këtë ka pasur mjaft kohë, megjithatë është

zhvilluar një diskutim. Në shumicën e rasteve për të marrë ndonjë sqarim, por ka pasur edhe disa vërejtje prej të cilave disa janë të përfshira në versionin final. Njëkohësisht mbetet detyrë e kryesisë që edhe në të ardhmen të kujdesen që Statuti të përmirësohet sipas kërkesave të anëtarësisë. Pas hedhjes në votim Statuti i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës është aprovuar njëzëri.

2. Zgjedhja e kryesisë dhe e kryetarit;

Kryesuesi z. Avdy Gërvalla ia dha fjalën z. Endri Veshi i cili në emër të KO propozoi që KO të shndërrohet në Kryesi të KShGj-së dhe njëkohësisht kërkoi nga të pranishmit të propozohet ndonjë femër, pasi që në KO nuk është asnjë. Po ashtu kërkoi nga të pranishmit që të propozojnë ndonjë kandidat nga komuna e Vitisë pasi që në territorin e kantonit të Gjenevës ka më së shumti shqiptar nga kjo komunë e Kosovës. Pas propozimeve lista e kandidatëve u zgjerua edhe me këta persona:

1. Afërdita Krasniqi
2. Lutfi Rexha
3. Lah Jashari
4. Nasuf Nuhiu
5. Agim Sherifi

Pas votimit, anëtarët e KO bashkë me kandidatët e propozuar nga publiku, në mënyrë unanime u zgjodhën për anëtarë të Kryesisë të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës.

Z. Endri Veshi, po ashtu në emër të KO propozoi z. Ali Mehmeti për kryetar të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës. Edhe ky propozim u aprovua njëzëri.

Pas këtij votimi, z. Ali Mehmeti mori fjalën. Ai i falënderoi të pranishmit në besimin e dhënë dhe vazhdoi me drejtimin e mbledhjes.

3. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë;

Kryetari i porsazgjedhur z. Ali Mehmeti doli me propozimin e KO që lartësia e anëtarësisë të përcaktohet në vlerë prej 100CHF/vit për anëtar ose për familje, ku me familje konsiderohet një çift bashkëshortor me fëmijë të mitur, ose të rritur, por në shkollim dhe pa të ardhura. Kjo nuk do të thotë se nuk mund të derdhen edhe shuma tjera në xhirollogarinë e KShGj-ës, më të mëdha apo më të vogla, por këto do të konsiderohen si donacione. Propozimi u aprovua njëzëri.

4. Zgjedhja e anëtarëve për organin e kontrollit të kontos;

Z. Ali Mehmeti njofton të pranishmit se ky organ duhet të ketë më së paku 3 anëtarë dhe se detyra e tij është të kontrolloj transaksionet financiare të kryesisë gjatë një viti. Në emër të KO ai propozon një anëtar nga kryesia dhe ky është z. Endri Veshi, kurse kërkon nga të pranishmit të propozojnë edhe dy të tjerët, mundësisht dikë që ka njohuri nga kontabiliteti. Për dy kandidatët tjerë propozohen Ilir Sahiti dhe Avdil Hamza.

Pas votimit, Endri Veshi, Ilir Sahiti dhe Avdil Hamza njëzëri zgjidhen për anëtarë të organit të kontrollit të kontos.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë morri fjalën anëtari i shquar i komunitetit tonë, prof. Ismet Hamiti, ish ekspert i Organizatës Ndërkombëtare për Telekomunikacion dhe kumbara e operatorit të telefonisë mobile të Kosovës, Vala. Ai na foli mbi përvojat e veta rreth organizimit të komuniteteve të ndryshme nëpër botë ku atij i ka rastisur të qëndroj dhe mbi nevojën që edhe ne të organizohemi në mënyrat e ngjashme. Mënyrë kjo, që ofron shërbime të ndryshme për anëtarët e komunitetit, duke besuar se themelimi i sotshëm do të zhvillohet në këtë drejtim.

Kuvendi mbylli punimet në ora 19h30 dhe u përmbyll me një aperitiv modest.

Procesmbajtës:

Nexhmedin Ilazi



Sekretar

Ajet Hyseni



Kryetar

Ali Mehmeti



Në Gjenevë, me 14 prill 2013.